



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE "STILIANO BANDILLI"
BERAT



Nr. 52 Prot.

Berat me 08/02/2023

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", Urdhëzimit nr 14, datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe të formimit profesional", Kreu XXI Neni 108. "Lëvizja paralele e personeli mwsimdhwnws nw ofruesit publikw tw AFP-sw

Shkolla e mesme profesionale "Stiliano Bandilli", ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin Mwsimdhwnws i praktikws profesionalr(me kohw tw plotw)

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- b) të jetë në kushte shëndetsore që e lejojnë të kryejë detyrën
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
- e) të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- f) të demostrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Alikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë të paktën nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë me kualifikimin profesional (dega Mekanikë)
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën në të cilën ka kryer studimet
- c) të njohë, të përdorë teknologjinë e informacionit

2. Dokumentat e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin
- b) jetëshkrimin(CV)
- c) kartën e identitetit
- d) diplomën
- e) librezën e punës
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetsore
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm
- l) të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose të noterizuara
- m) dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara

dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e shkollës , brenda datës 21.02.2023 (5 ditë pune nga publikimi i shpalljes).

Drejtor i shkollës

Ing . Kozeta Nushi

